



SONDAZH I OPINIONIT PUBLIK

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE



advocacy for
open government

supporting the right to know
in South East Europe

Financuar nga:
Bashkimi European dhe KFOS-i



Deklaratë mohimi:

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Institutit Riinvest dhe në asnjë rrethanë nuk i paraqet pikpamjet e Bashkimit Evropian apo KFOS-it

Faqosja dhe Dizajni

Faton Selani

Originali është shkruar në anglisht

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org





SONDAZH I OPINIONIT PUBLIK

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE



advocacy for
open government

supporting the right to know
in South East Europe

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrja.....	2
2. Metodologjia e përgjithshme	3
3. Informata të përgjithshme.....	4
4. Niveli i besueshmërisë në institucione.....	5
5. Transparenca	6
6. Pjesëmarrja publike	7
7. Llogaridhënia.....	8
8. Përdorimi i teknologjisë.....	9

1. HYRJA

Ky dokument prezanton të gjeturat e sondazhit të opinionit publik të kryera në Qershor 2014. Sondazhi ka për qëllim matjen e nivelit të besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve relevante, si dhe të njëjtën kohë të kuptojë perceptimet e tyre ndaj temave të ndryshme që ndërlidhen me shtyllat kryesore të platformës Partneriteti i Hapur Qeverisës (PHQ), ku hyjnë transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja publike dhe teknologjia. Një sondazh shumë i përafërt i opinionit publik është realizuar përgjatë periudhës së njëjte të vitit të kaluar; prandaj ky dokument po ashtu ndjek ndryshimet më të dukshme në perceptimet e qytetarëve në temat e lartë-cekura.

Pjesa e mbetur e këtij dokumenti të shkurtër është e organizuar si në vazhdim: *Seksioni 2* sjell metodologjinë e përgjithshme të përdorur në realizimin e sondazhit të opinionit publik. *Seksioni 3* sjell profilin demografik dhe statusin e punës të anketuarve të intervistuar. *Seksioni 4* sjell gjetjet në nivel të besimit që qytetarët kanë në institucione. *Seksioni 5 dhe 6* prezantojnë të gjeturat që tentojnë të zbulojnë se si qytetarët perceptojnë transparencën dhe pjesëmarrjen publike. *Seksioni 7* tregon se si qytetarët perceptojnë influencën e organizatave të ndryshme në vendime qeveritare. *Seksioni 8* prezanton disa të gjetura që zbulojnë nëse qytetarët e përdorin teknologjinë për të vendosur ndonjë kontakt me qeveritë e tyre lokale. Në të gjithë këta sektorë, të gjeturat aktuale janë krahasuar me ato të realizuara në sondazhin e realizuar në vitin 2013.

2. METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME

Sondazhi i opinionit ka përfshirë 1,000 të anketuar, të përzgjedhur rastësisht nga e gjithë Kosova. Shpërndarja e mostrës është mjaftueshëm e gjerë që të mundësojë rezultate të rëndësishme statistikore në nivel besueshmërie 99 përqind.

Në procesin e dizajnit të pyetësorit ka marrë pjesë Instituti Riinvest dhe ekspertë nga rrjeti PASOS. Pyetësori që është përdorur përmbante pesë seksione kryesore që ishin të fokusuar në: besim, transparencë, pjesëmarrje publike, llogaridhënie, dhe përdorim të teknologjisë. Para se të dilte sondazhi për t'u realizuar plotësisht, është testuar fillimisht me 50 të anketuar për të kuptuar nëse ka 'defekte' të dukshme, ose nëse pyetje të caktuara duhej të modifikoheshin në mënyrë që të siguroheshin përgjigje të sakta nga të anketuarit. Përveç kësaj, ekipi hulumtues testoi kohëzgjatjen, ku mësoi se një anketë mesatarisht zgjati rreth 25 minuta.

Ekipi i Riinvest-it rekrutoi studentët më të mirë të Kolegjit Riinvest si anketues. Të gjithë anketuesit janë trajnuar. Si pjesë e trajnimit, regjistruerëve u është dhënë një manual trajnimi që shpjegon: rëndësinë dhe qëllimet e përgjithshme të sondazhit; kodin e veshjes; dhe shpjegime tjera të detajuara lidhur me pyetësorin. Grupe të vogla (2-deri-5) të anketuesve kanë punuar nën udhëheqjen e një lideri ekipor. Në terren, lideri ekipor ka vizituar disa herë 15 përqind të të anketuarve për çdo anketues, duke i falënderuar për bashkëpunimin e tyre. Gjatë këtyre vizitave janë ri-pyetur një numër pyetjesh me qëllim të verifikimit. Përveç kësaj, prej zyrave të Riinvest-it, një proces i ngjashëm verifikues është realizuar përmes telefonit nga ekipi hulumtues dhe Lideri i Projektit për një 15 përqindësh tjetër të të anketuarve të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Pasi që janë kthyer pyetësorët, ato janë ruajtur në ndërtesën e Riinvest-it. Një kontroll logjik po ashtu është kryer – kjo ka shërbyer për të identifikuar nëse ka pasur ndonjë pyetësor të mbushur gabimisht nga anketuesit.

Të dhënat e mbledhura janë koduar nga personeli me përvojë në përdorimin e 'Microsoft EXCEL-it'. Pastaj, të dhënat janë analizuar duke përdorur 'SPSS'. Ky mjet statistikor i përdorur për të lehtësuar kontrollimin e të dhënave dhe për kryerjen e analizave bazike statistikore, të cilat janë të prezantuara në seksionet në vazhdim.

3. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Në vazhdim janë prezantuar disa informata relevante të profilit demografik, punësimit dhe statusit të të ardhurave të respondentëve:

- Rreth 54 përqind ishin meshkuj, përderisa përafërsisht 46 përqind ishin femra.
- Mosha mesatare ishte 33.8; i anketuari më i ri ishte 16 vjeçar, përderisa më i vjetri 79.
- Shumica e të anketuarve të intervistuar ishin shqiptarë (rreth 91 përqind) dhe Serb (7 përqind) përderisa pjesa e mbetur ishin boshnjakë, turq dhe egjiptianë.
- Rreth 88 përqind ishin myslimanë; pjesa tjetër ishin ortodoksë (7 përqind), katolikë (4 përqind) dhe një përqindje shumë e vogël (më pak se 1 përqind) ateistë.
- Rreth 51 përqind ishin të martuar, rreth 45 përqind nuk ishin martuar asnjëherë, 2 përqind ishin të veja, rreth 2 përqind nuk e kanë deklaruar statusin e tyre martesor dhe më pak se 1 përqind ishin të ndarë (divorcuar).
- Rreth 63 përqind jetonin në qytete, rreth 19 përqind në qyteza dhe 18 përqind në zona rurale.
- Rreth 47 përqind ishin të punësuar në Seksioni n privat, 22 përqind në atë publik, rreth 9 përqind të vetëpunësuar dhe 4 përqind në organizata jo-qeveritare dhe organizata tjera. 18 përqindëshi i mbetur ishin të papunësuar.
- Të ardhurat mesatare të familjes së të anketuarit ishin 667€.

4. NIVELI I BESUESHMËRISË NË INSTITUCIONE


Figura 1 zbulon nivelin e besueshmërisë që qytetarët e Kosovës kanë në institucione të ndryshme në 2014-ën dhe në të njëjtën kohë tregon nivelin e besueshmërisë nga viti i kaluar, për qëllime krahasimi. Sipas rezultateve të studimit, institucionet ndërkombëtare, KFOR-i dhe Bashkimi Evropian (BE), janë institucionet më të besueshme me rreth 67 përqind, respektivisht 64 përqind të qytetarëve që ju besojnë atyre *plotësisht* ose *deri në njëfarë mase*¹; përcjellë nga Organizatat Jo-qeveritare (me rreth 62 përqind). Në anën tjetër, institucionet me besueshmërinë më të ulët dalin të jenë Partitë Politike, Presidenca, si dhe tri pushtetet, përkatësisht Qeveria e Kosovës, Sistemi Gjyqësor dhe Parlamenti i Kosovës. Përafërsisht vetëm 22, respektivisht 23 përqind e qytetarëve, ju besojnë dy institucioneve të mëparshme *plotësisht* ose *deri në njëfarë mase*; përdërisa përqindjet sillen prej 24 deri në 31 për tri degët tjera qeverisëse. Në një studim të kryer nga Camaj (2014)², institucionet ndërkombëtare me mandat në Kosovë, po ashtu pranojnë nivele më të larta të besueshmërisë vis-à-vis institucioneve lokale (si p.sh. Qeveria dhe Parlamenti). Kjo sugjeron që institucionet lokale të Kosovës janë ende të ndjeshme dhe nuk janë të gatshme që të reagojnë përgjegjshëm ndaj kërkesave të qytetarëve. Ja vlen të përmendet që niveli i besimit që qytetarët kanë ndaj institucioneve lokale, përkatësisht ndaj partive politike dhe sistemit gjyqësor, është pak a shumë i ngjashëm me atë të qytetarëve Serb³ dhe Maqedon³ ndaj institucioneve të tyre.

Kur këto të dhëna krahasohen me ato të sondazhit të kryer në vitin 2013, duket se niveli i besueshmërisë në institucione në përgjithësi është në ngritje. Ngritja më e evidente vërehet tek Misioni i Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX), Administrata Publike dhe Kryetarët Komunalë (rreth 23, 13, 12 pikë të përqindjes më lartë). Ndryshimi në opinionin publik sa i përket EULEX-it është i ndërlidhur me faktin që ky institucion ka intensifikuar luftën kundër krimit ekonomik, duke arrestuar disa figura të rëndësishme publike në vend, duke përfshirë këtu edhe disa deputetë. Të gjitha arrestimet patën hapësirë mediale; kjo si duket pati ndikim të dukshëm në perceptcionin e qytetarëve. Në anën tjetër, ja vlen të përmendet që niveli i besueshmërisë në media dhe Policinë e Kosovës ka shënuar rënie (secila me rreth 4 pikë përqindje). Në fakt, këto dyja janë cituar si institucionet më të besuara në 2013-ën.

¹ Shënim: Të anketuarit janë pyetur që të vlerësojnë institucionet në shkallë rendore prej 1 deri në 4 (1-nuk ka besim; 2-pak besim; 3 – besim deri në njëfarë mase; 4 – besim i madh)

² Camaj, L.C., 2014. Media Use and Political Trust in an Emerging Democracy: Setting the Institutional Trust Agenda in Kosovo. *International Journal of Communication*, 8, 187–209.

Figura 1. Niveli i besimit ndaj institucioneve (% e atyre që ju besojnë *plotësisht* ose *deri në një masë*)



Burimi: Kalkulimet e autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit

5. TRANSPARENCA


Figura 2 tregon qëndrimet e qytetarëve të Kosovës ndaj disa deklarata të ndërlidhura me transparencën. Shumica e të anketuarve konsiderojnë që publiciteti i tepërt negativ në veprimet qeveritare e bën Kosovën të ndjeshme dhe i pengon IHD-të (rreth 73 përqind ‘*pak a shumë pajtohen*’ ose ‘*pajtohen plotësisht*³’). Një përqindje shumë më e vogël e qytetarëve të intervistuar, rreth 43 përqind, besojnë (‘*pak a shumë pajtohen*’ ose ‘*pajtohen plotësisht*’) që shërbyesit civil të cilët nxjerrin në shesh informata të klasifikuara nga veprimet qeveritare duhet të dënohen. Kjo tregon që shumica e qytetarëve të Kosovës (rreth 57 përqind) kërkojnë një qeveri e cila nuk bën kurrfarë kompromisi me transparencën radikale. Proporcioni i të anketuarve të cilët ‘*pak a shumë pajtohen*’ ose ‘*pajtohen plotësisht*’ që informacioni lidhur me etninë dhe religjionin mbi shërbyesit civil duhet të grumbullohet është rreth 41 përqind, duke sugjeruar që politikat e rekrutimit duhet të mbështeten kryesisht mbi merita, duke mos lejuar hapësirë për kurrfarë lloj diskriminimi. Në fund, më pak se një e katërta e të anketuarve, apo rreth 23 përqind, janë të mendimit (‘*pak a shumë pajtohen*’ ose ‘*pajtohen plotësisht*’) që anëtarët e parlamentit dhe kuvendeve komunale kanë të drejtë t’i mbajnë apo t’i klasifikojnë informatat mbi pasurinë dhe të ardhurat e tyre si të fshehta apo të besueshme.

³ Shënim: Të anketuarit janë pyetur që të vlerësojnë deklaratat në shkallë rendore prej 1 deri në 4 (1-nuk pajtohem aspak; 2-pajtohem deri diku; 3 – pak a shumë pajtohem; 4 – pajtohem plotësisht)

Është e definuar me ligj⁴ që zyrtarët publikë duhet të deklarojnë të gjithë pronën e tyre Agjencia Kundër-Korrupsion (AKK). Deri me tani, sipas njohurive të autorëve, asnjëri prej zyrtarëve publik nuk refuzoi ta përmbushë këtë obligim; i cili tregon që qytetarët e Kosovës në përgjithësi nuk e perceptojnë si veprim dëmtues, që e prekë privatësinë e individëve.

Kur përgjigjet në pohimet e transparencës janë krahasuar me përgjigjet e anketës tonë të realizuar përgjatë 2013-ës, del se nuk kanë ndodhur ndryshime të mëdha në proporcion të qytetarëve (maksimum 3 përqind pikë devijimi).

Figura 2. Perspektiva e të anketuarve përmes deklaratave të ndryshme të ndërlidhura me transparencë (% e atyre që *'pak a shumë pajtohen'* ose *'pajtohen plotësisht'*)



Burimi: Kalkulimi i autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit


6. PJESËMARRJA PUBLIKE

Rezultatet tregojnë që rreth 57 përqind e qytetarëve të intervistuar *'pak a shumë pajtohen'* ose *'pajtohen plotësisht'*⁴ me pohimin që blogjet dhe komentet në internet nuk e përfaqësojnë opinionin publik ashtu siç duhet. Kjo përqindje është rreth 10 pikë përqindjeje më e lartë krahasuar me 2013-ën, duke sugjeruar që numri i njerëzve që nuk ju besojnë blogjeve dhe komenteve është në rritje. Kjo rënie mund t'i shënohet numrit në rritje të njerëzve të cilët në tentim të avancimit të agjendave politike, qëllimisht japin opinione mashtruese.

Për më tepër, përafërsisht 55 përqind e qytetarëve të anketuar janë të mendimit (*'pak a shumë pajtohen'* ose *'pajtohen plotësisht'*) që një anëtar i parlamentit bartë të gjithë përgjegjësinë (deleguar nga qytetarët) për të formësuar çështjet publike. Proporcioni është më i ulët (për rreth 3 pikë përqindjeje) krahasuar me proporcionin e 2013-ës. Kjo rënie, edhe pse e vogël, është prapë përshkruese që qytetarët e Kosovës janë duke u vetëdijësuar më shumë që roli i tyre në sferën publike shkon përtej votimit.

Rreth 46 përqind të të anketuarve besojnë (*'pak a shumë pajtohen'* ose *'pajtohen plotësisht'*) që dëgjimet publike janë thjeshtë ngjarje formale dhe vështirë që kanë ndonjë ndikim në vendimet e marra nga zyrtarët komunalë – që i bie 6 përqind pikë më ulët krahasuar me vitin e kaluar. Për më shumë, afërsisht 35 përqind e të anketuarve tregojnë që një qytetar i rëndomtë nuk ka ekspertizë të mjaftueshme për të vendosur nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq. Krahasuar me 2013-ën, kjo shënoi një rënie të madhe (rreth 10 përqind pikë më pak), duke sugjeruar që përveç qeverisë, qytetarët kanë filluar të pranojnë ekspertizën e shoqërisë civile dhe organizmave tjerë. Përfundimisht, 23 përqind e vlerësojnë lobimin si të dëmshëm për shoqërinë; përgjigjet e qytetarëve për këtë deklaratë janë disi të ngjashme me ato të 2013-ës. Për përfaqësim vizual dhe të detajuar shih Figurën 3.

Figura 3. Perspektiva e të anketuarve në deklarata që vlerësojnë pjesëmarrjen publike (% e atyre që *'pak a shumë pajtohen'* ose *'pajtohen plotësisht'*)



Burimi: Kalkulimi i autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit

7. LLOGARIDHËNIA


Figura 4 paraqet një listë rendore që tregon perceptimet e qytetarëve sa i përket influencës së organizatave të ndryshme në procesin e vendimmarrjes së qeverisë. anëtarët e parlamentit (AP-të) kryesojnë listën, me rreth 60 përqind të të anketuarve duke deklaruar se AP-të kanë *'ndikim të mjaftueshëm'* ose *'ndikim të lartë'*⁴; të ndjekura nga kompanitë e mëdha ndërkombëtare (me rreth 47 përqind) dhe partitë opozitare (me rreth 45 përqind).

Në anën tjetër, Institucionet Fetare janë perceptuar si organizatat me ndikimin më të vogël; për të qenë më specifik, vetëm 19 përqind e qytetarëve të anketuar besojnë që institucionet

fetare kanë *'ndikim të mjaftueshëm'* ose *'ndikim të lartë'* në vendimet qeveritare. Ndërsa Organizatat Jo-Qeveritare edhe pse janë vlerësuar në mesin e organizatave më të besuara, janë perceptuar si të dytat për nga ndikimi më i ulët; vetëm rreth 21 përqind pajtohen që ato kanë *'ndikim të mjaftueshëm'* ose *'ndikim të lartë'*.

Kur janë krahasuar të gjeturat e këtij viti me ato të vitit 2013, del se Mediat kanë shënuar rënien më të madhe; specifikisht proporcioni i të anketuarve të cilët pajtohen me idenë që mediat kanë *'ndikim të mjaftueshëm'* ose *'ndikim të lartë'* në vendimet qeveritare ka shënuar rënie për 11 pikë përqindjeje (prej 48 në 37 përqind). Në anën tjetër, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm shënoi ngritjen më të madhe mes organizatave të renditura; proporcioni shënoi ngritje saktësisht për 4 pikë përqindjeje (prej 33 në 37 përqind).

Figura 4. Ndikimi i organizatave të ndryshme në vendimet qeveritare (% e atyre të cilët thonë që organizatat në vazhdim kanë *'ndikim të mjaftueshëm'* ose *'ndikim të lartë'*)




Burimi: Kalkulimet e autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit

8. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË

Kur të anketuarit u pyetën nëse qeveria lokale ka ueb-faqe, rreth 56 përqind deklaruan që *'nuk dinë'*, afërsisht 37 përqind u përgjigjën *'Po'* dhe rreth 7 përqind u përgjigjën *'Jo'*. Shpërndarja e rezultateve për ekzistencën e ueb-faqeve ka qenë thuajse e njëjtë në 2013-ën (për paraqitje grafike, shih Figurën 5).

Figura 5. Njohuritë e qytetarëve për ueb-faqet e qeverive lokale (në %)



Burimi: Kalkulimet e autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit

Vetëm rreth 29 përqind e atyre që dinë që qeveritë e tyre lokale kanë ueb-faqe, thonë se ata më së shumti i përdorin ueb-faqet për t'i kontrolluar programet dhe ngjarjet në qytetin/qytezën e tyre (shih Figurën 6); vetëm rreth 23 përqind të të anketuarve të cilët i përdorin ueb-faqet e qeverive lokale deklarojnë se ata i përdorin ueb-faqet për ti dorëzuar dokumentet dhe për të shkarkuar formularë për administratën lokale. Madje numër më i vogël i të anketuarve i përdorin ueb-faqet e qeverisë lokale për të dërguar ankesa ose komente stafit të komunës ose për shkarkimin e dekreteve apo rezolutave të qeverisjes lokale (rreth 15 përqind prej 36 përqind në të dyja). Arsyeja e fundit për t'i përdorur ueb-faqet e qeverisë lokale është për të komunikuar me këshilltarin lokal (rreth 11 nga 36 përqind e të anketuarve e dinë që qeveria e tyre lokale ka ueb-faqe). Rezultatet për të gjitha këto deklarata janë të ngjashme me ato të 2013-ës, përpos njërës që ka të bëjë me dorëzimin dhe shkarkimin e dokumenteve, e cila del të jetë 6 pikë përqindjeje më e ulët.

Figure 6. Qëllimet e përdorimit të ueb-faqes komunale (% e atyre që kanë deklaruar 'shpesh' ose 'shumë shpesh')



Burimi: Kalkulimet e autorit nga rezultatet e sondazhit të opinionit

